



Hymeri Elevators LLC

Pozita: Menaxher/e i/e Financave
Divizioni/Departamenti: Administratë dhe Financa
Raporton te: Shefi Kryesor Financiar - Hymeri Group.
Afati për aplikim: 23.11.2019

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Përgatitë për aprovim buxhetin vjetor të kompanisë dhe siguron monitorimin e tij në baza mujore;
- Përgatitë raporte javore mbi rrjedhën e parasë dhe është përgjegjës për menaxhimin e likuiditetit në kompani;
- Është përgjegjës për mbarëvajtjen e proceseve që ndërlidhen me kontabilitetin dhe financat e kompanisë;
- Mbikëqyrë dhe përgatitë raporte në baza ditore për llogaritë bankare dhe arkën e kompanisë;
- Është përgjegjës për përgatitjet dhe dorëzimin e librave shitës, blerës dhe raportimin e deklaratave të TVSH-së dhe raporteve tjera sipas kërkesave të ATK-së;
- Përgatitë pasqyrat financiare vjetore për kompaninë;
- Bënë planifikimin dhe harmonizmin e pagesave me inkasime dhe koordinon procesin me zyrtarët e shitjes në terren etj;
- Është përgjegjës për menaxhimin e depos dhe stokut të kompanisë;
- Bënë koordinimin e procesit të blerjeve dhe ekzekuton pagesën e faturave nga blerjet dhe detyrimet tjera;
- Koordinohet me kompanitë tjera të grupit mbi çështjet financiare, të kontabilitetit dhe raportimit;
- Është përgjegjës për përgatitjen e listës së pagave, përfshirë edhe shtesat nga puna jashtë orarit apo bonuset;
- Është përgjegjës për menaxhimin e aseteve të kompanisë përfshirë edhe depon;
- Shërben si person kontaktues për palët e jashtme përfshirë auditorët e jashtëm, përmbaruesit privat, noterët etj; dhe
- Detyra tjera të kërkuara nga mbikëqyrësi.

Kualifikimet dhe njohuritë e kërkuara:

- Diplomë superiore në ekonomi, financa apo kontabilitet;
- Përvojë tre vjeçare në fushën e kontabilitetit, financave;
- Çertifikatën e Teknik i Kontabilitetit nga SCAAK;
- Njohja e mirë e gjuhës angleze;
- Njohuri shumë të mira në fushën e IT, MS Office, përfshirë njohjen e programeve të kontabilitetit.

Si të aplikoni?

Dokumentet e shkollimit përfshirë edhe kopjen e çertifikatave profesionale, dokumentet relevante mbi përvojën e punës i dërgoni në email: info@hymeri-kleemann.com apo drejtëpërdrejtë në: *Rr. Ahmet Krasniqi, Tregtia C2 H2, nr 7A, Prishtinë* (afër ndërtesës së komunës së Prishtinës, Arbëri).

Për çdo pyetje mund të kontaktoni edhe drejtëpërdrejtë në tel: 049 190 067